



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Opština Klokot/Komuna e Kllokot**

Datë : 27.09.2021

Në bazë të nenit 12, pika 12.2, paragrafi (d). Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03 / L-040; Neni 6 i Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 151/20 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit, përfundimin e kontratës dhe emërimit e përkohshëm; si dhe nenin 13. Pika 13.1 e Statutit të Komunës së Kllokotit Kuvendi komunal miraton:

VENDIM

për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues parauniversitar në territorin e komunës së Kllokotit

Neni 1.

Kuvendi i Komunës së Kllokotit miratoi vendimin në seancën e tetë të rregullt të mbajtur më 27 shtator 2021 për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues parauniversitar në territorin e komuna e Kllokotit.

Neni 2.

Anëtarët nga shkolla për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit PEOOI janë:

- Zorica Marinković – antare nga shkolla fillore „Marko Rajković„ në Vërbovc;
- Sladjan Dejanović – antar nga shkolla e mesme „Shkolla Teknike „në Vërbovc ;
- Trajan Trajković – antar nga shkolla fillore „Sveti Sava „ në Kllokot;
- Donjeta Trena – antare nga shkolla fillore „Gjon Sereqi„ në Mogillë

Për të gjitha shkollat e lartpërmendura (DKA), Drejtoria Komunale e Arsimit në komunë siguron një anëtare, Tanja Nisić, e cila është e punësuar në komunë dhe që është gjithashtu kryetare e komisionit.

Neni 3.

Komisioni në titull është i detyruar dhe ka për detyrë të zbatojë procedurën e plotë nga Udhëzimi Administrativ i MASHT Nr. 151/20 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve publike arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit, përfundimi i kontratës dhe emërimi i përkohshëm.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të vlefshmërisë së Ministrisë kompetente të Vetëqeverisjes Lokale. Kuvendi Komunal i Kllokotit do ta publikojë vendimin pas vlerësimit në web - faqen e komunës.

Kopja :

- Kabinetit kryetarit komunës ;
- DASHQSKRS
- Kryesuesit të K.K.Kllokot
- Arkivës komunale

Kryesuesi i Kuvendit komunal Kllokot

